



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 943 /

Tirane, date 9.7.2015

Drejtuar: Z. JEMIN BULICA
SHOQERIA "KOLOSIA KRISTAL" SH.P.K
RRUGA "MUSTAFA LLESHI" PALLATI 18, SHKALLA 1, APARTMENTI 4
TIRANE

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"
TIRANE

Z. RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE
TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1051 date 03.08.2007.

I nderuar z. Bulica,

Shoqëria "Kolosian Kristal" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1051 date 03.08.2007, për gëlqeror të mermerizuar, Kolosian, në Qarkun Kukës.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 2022 date 09.02.2015, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.943 date 10.02.2015, është propozuar revokimi i lejes së shfrytëzimit nr.1051 date 03.08.2007, për gëlqeror të mermerizuar, Kolosian, në Qarkun Kukës, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, për vitin 2014-2015.

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar të Shqipërisë" të ndryshuar që është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 të ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gërmen “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1051 datë 03.08.2007, për gëlqeror të mermerizuar, Kolosian, në Qarkun Kukës, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1051 datë 03.08.2007.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

